

MPJ-ja e Malit të Zi:
Nismat komunale kundër
Kosovës kanë zero efekt



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

A I DUHEN KOSOVËS LOBISTË NË SHBA?



Kosova ka mbetur pa kontrata aktive lobimi në ShBA që nga viti 2024, ndërsa ekspertët dhe ish-zyrtarët kanë qëndrime të ndryshme për rolin e lobistëve

privatë në promovimin e interesave të vendit në Uashington. Disa e konsiderojnë të domosdoshëm angazhimin e firmave lobuese për të siguruar qasje te vendimmarrësit

amerikanë, ndërsa të tjerë vlerësojnë se diplomacia zyrtare, ambasada dhe diaspora duhet të jenë shtyllat kryesore të përfaqësimit të Kosovës

**PROKURORIA
SPECIALE PËR
GËRMIMET NË
ZUBIN POTOK:
HETIMET PO
VAZHDOJNË NË
NJË LOKACION
TË TRETË**



**GRUDA: TAKIMET E KURTIT JANË
FARSË, NËSE NUK E MERR
PRESIDENTIN, AI PLANIFIKON
TA ÇOJË VENDIN NË ZGJEDHJE**



**BEGAJ TAKOHET ME AMBASADORIN
E EKUADORIT, IA KËRKON NJOHJEN
E KOSOVËS**

**SUPREMJA SHFUQIZON UDHËZIMIN
ADMINISTRATIV PËR GRADIMIN E
ZYRTARËVE POLICORË**

**BE-JA KËRKON PEZULLIMIN
E RRËNIMEVE NË UJMAN DERI NË
VENDIMIN E GJYKATËS**

**AUV-i: NË 46 RASTE U GJET
PRANI OSE MOSDEKLARIM I VAJIT
TË PALMËS NË PRODUKTET E
QUMËSHITIT**

**GAP-i PUBLIKON INDEKSIN E
TRANSPARENCËS BUXHETORE,
10 KOMUNA MARRIN PIKËT
MAKSIMALE**

SPORT



**KOSOVA ME 163 SPORTISTË NË
LOJËRAT MESDHETARE**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KRIZA E EMIGRANTËVE, VON DER LEYEN: VENDET ANËTARE TË BE-SË TË VEPROJNË SË BASHKU PËR MBROJTJEN E KUFIRIT TË JASHTËM

BRUKSEL, 4 GUSHT - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, u ka bërë thirrje vendeve të Bashkimit Evropian (BE) të veprojnë së bashku për mbrojtjen e kufijve të jashtëm, pas fluksit masiv të emigrantëve nga Maroku drejt enklavës spanjolle të Ceutës.

Sipas autoriteteve spanjolle, rreth 69 500 emigrantë janë kthyer në Marok, ndërsa bilanci i viktimave ka arritur në 72 në anën spanjolle dhe 11 në anën marokene.

Në një letër drejtuar kryeministrit spanjoll Pedro Sanchez, von der Leyen ka

vlerësuar reagimin e autoriteteve spanjolle, por ka theksuar se ngjarja dëshmoi nevojën për forcimin e mbrojtjes së kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian.

Ajo ka kërkuar monitorim më të rreptë, përdorimin e barrierave fizike aty ku është e nevojshme dhe një përgjigje të koordinuar evropiane ndaj emigracionit të parregullt. Kriza ka nxitur edhe përplasje politike brenda BE-së. Italia ka pezulluar përkohësisht zbatimin e marrëveshjes Shengen me Spanjën, një vendim që është mbështetur edhe nga Finlanda dhe

Danimarka, ndërsa Çekia ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të Spanjës nga zona Shengen.

Nga ana tjetër, kryeministri spanjoll Pedro Sanchez ka akuzuar disa qeveri evropiane se po politizojnë krizën dhe ka theksuar se Ceuta nuk është pjesë e zonës Shengen.

Ndërkohë, autoritetet spanjolle kanë deklaruar se situata në Ceuta po i rikthehet gradualisht normalitetit, ndërsa po vijojnë punën për vendosjen e një barriere lundruese në det, me qëllim pengimin e kalimeve të paligjshme.



TRUMPI PËRPLASET ME GJIGANTËT E NAFTËS PAS LUFTËS ME IRANIN



UASHINGTON, 4 GUSHT - Presidenti amerikan, Donald Trump u ka kërkuar kompanive të mëdha të naftës që të ndërmarrin hapa për uljen e çmimeve të karburanteve, duke i akuzuar se kanë përfituar shumë nga rritja e çmimit të naftës gjatë luftës me Iranin.

Trumpi ka kritikuar veçanërisht kompanitë “Chevron” dhe “ExxonMobil”, duke deklaruar se ato kanë përfituar ndjeshëm nga rritja e çmimeve të naftës, pasi lufta ka ndikuar në furnizimet përmes Ngushticës së Hormuzit. Ai ka deklaruar se, nëse konflikti


me Iranin përfundon, çmimet e naftës do të bien ndjeshëm. “Kane fituar shumë para, shumë para. ‘Chevron’ shumë, ‘ExxonMobil’ gjithashtu shumë”, ka deklaruar Trump, duke kërkuar që kompanitë të ulin çmimet për konsumatorët. Çmimi ndërkombëtar i naftës Brent ka rënë me më shumë se 4 për qind të hënën, duke shkuar në rreth 84 dollarë për fuçi, pas shpresave për përparim diplomatik në zgjidhjen e konfliktit. Megjithatë, çmimet mbeten më të larta se para nisjes së luftës. Sipas një sondazhi të

fundit të “CBS News”, rreth gjysma e amerikanëve kanë deklaruar se rritja e çmimeve të karburanteve po u shkakton vështirësi financiare. Kompania “ExxonMobil” ka refuzuar të komentojë, ndërsa “Chevron” nuk ka dhënë ende një përgjigje zyrtare. Sipas të dhënave të Administratës Amerikane të Informacionit për Energjinë (EIA), çmimi i naftës bruto përbën rreth 51 për qind të koston së një litri karburant, duke qenë faktori kryesor që ndikon në çmimin final për konsumatorët.

ZELENSKY SHKARKON AMBASADOREN E UKRAINËS NË SHBA

KIEV, 4 GUSHT - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka shkarkuar ambasadoren e Ukrainës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), Olha Stefanishyna, një vendim që pritej pas riorganizimit të Qeverisë ukrainase muajin e kaluar.

Shkarkimi, i bërë i ditur përmes një dekreti, ka ndodhur në një kohë kur Kievi po ushtron presion të madh ndaj Uashingtonit për të siguruar më shumë raketa të mbrojtjes ajrore



Patriot, me qëllim ndalimin e sulmeve ruse.

Në një postim në “Facebook”, ku ka publikuar edhe një letër me kërkesën për t’u liruar nga

detyra, Stefanishyna ka deklaruar se vendimi ka qenë i saj dhe se është “nxitur nga rrethanat personale”. Ajo e ka cilësuar detyrën e saj në Uashington si “nderin më të madh” të jetës së saj. “Ne rritëm furnizimin me armë amerikane dhe ruajtëm mbështetjen pikërisht në kohën kur klima politike në Uashington po ndryshonte kundër nesh”, ka shtuar ajo.

Stefanishyna, ish-zëvendës-kryeministre dhe ish-ministre e

Drejtësisë, është emëruar ambasadore në Uashington në korrik të vitit të kaluar.

Ky post është kyç për Ukrainën, e cila varet nga dërgesat e armëve amerikane dhe këmbimi i inteligjencës në konfliktin kundër Rusisë.

Marrëdhëniet mes Zelenskyt dhe homologut të tij amerikan, Donald Trump, kanë qenë të tensionuara dhe, herë pas here, të trazuara. Megjithatë, presidenti republikan kohët e fundit ka shfaqur një qasje më

inkurajuese ndaj udhëheqësit ukrainas.

Sipas mediave ukrainase, Stefanishyna është nën hetim nga agjencia kundër korrupsionit e Ukrainës, nën dyshimet për keqbërje, megjithëse ndaj saj nuk është ngritur zyrtarisht ndonjë aktakuzë. Zelensky, i cili ka bërë ndryshime në qeveri në korrik, ende nuk ka njoftuar se kush do ta zëvendësojë Stefanishynan në postin e ambasadores në Uashington.

EVROPA PËRVËLOHET NGA TEMPERATURAT E LARTA, ZELANDA E RE GODITET NGA I FTOHTI POLAR

WELLINGTON, 4 GUSHT - Një shpërthim i fuqishëm polar ka përfshirë Zelandën e Re, duke sjellë reshje dëbore edhe në zonat me lartësi të ulëta, çka ka shkaktuar mbylljen e rrugëve, shkollave dhe ndërprerjen e shërbimeve të trageteve.

Sipas New Zealand Herald, dëbora ka rënë në disa pjesë të Ishullit Jugor, ndërsa sistemi i motit të ftohtë ka përfshirë të gjithë vendin.

Policia u ka bërë thirrje banorëve të qytetit Dunedin të shmangin udhëtimet, përveç rasteve kur janë të domosdoshme, për shkak të dëborës dhe ngricës në rrugë. Autoritetet kanë lëshuar gjithashtu paralajmërime për reshje dëbore në disa akse kryesore rrugore. Moti i ashpër ka ndikuar edhe në procesin mësimor. Të gjitha shkollat fillore, të mesme dhe kopshtet në zonat Dunedin, Mosgiel,

Port Chalmers dhe Waikouaiti janë mbyllur për ditën e sotme. Po ashtu, është mbyllur edhe shkolla e mesme “East Otago” në Palmerston.

Kushtet atmosferike janë përkeqësuar edhe në Ngushticën e Kukut, që ndan Ishullin Verior nga ai Jugor. Erërat e forta kanë detyruar kompanitë e trageteve të anulojnë udhëtimet. Kompania “Interislander” ka anuluar katër lundrime mes

Wellingtonit dhe Pictonit, ndërsa “Bluebridge” ka pezulluar të gjashtë kalimet e planifikuara për sot, si dhe dy shërbime të parashikuara për mëngjesin e së mërkurës.

Shërbimi meteorologjik “MetService” ka lëshuar një paralajmërim për dallgë të mëdha në bregdetin Wairarapa, në jug të Ngawit, ku parashikohen valë deri në 6 metra deri në orët e para të së mërkurës.



MPJ-ja E MALIT TË ZI: NISMAT KOMUNALE KUNDËR KOSOVËS KANË ZERO EFEKT

PODGORICË, 4 GUSHT - Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) e Malit të Zi, e cila drejtohet nga Ervin Ibrahimoviq, ka deklaruar se vendimet e disa komunave malazeze për “çnjohjen” e pavarësisë së Republikës së Kosovës nuk përfaqësojnë asgjë dhe nuk kanë kurrfarë efekti. “Sa i përket vendimeve të miratuara nga disa kuvende komunale lidhur me njohjen e Republikës së Kosovës, dëshirojmë të theksojmë se njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk kanë as kompetencë kushtetuese dhe as ligjore në fushën e politikës së jashtme, e po ashtu nuk janë të autorizuar të miratojnë akte që prodhojnë çfarëdo efekti sipas së drejtës ndërkombëtare”, kanë deklaruar nga MPJ-ja e Malit të Zi në një përgjigje për “Express”. Podgorica zyrtare ka sqaruar se politika e jashtme dhe aspektet që kanë të bëjnë me njohjen e shteteve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike janë kompetencë ekskluzive e

autoriteteve shtetërore të Malit të Zi, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. MPJ-ja e Malit të Zi ka kërkuar nga bartësit e funksioneve publike respektimin e rendit kushtetues të vendit dhe që të njëjtët të sigurohen se nuk e dëmtojnë imazhin e Malit të Zi dhe nuk krijojnë tensione të panevojshme. “Ministria e Punëve të Jashtme pret që të gjithë bartësit e funksioneve publike ta respektojnë rendin kushtetues, kompetencat e institucioneve shtetërore dhe kredibilitetin ndërkombëtar të Malit të Zi, si dhe të sigurojnë që veprimet e tyre të kontribuojnë në ruajtjen e reputacionit të vendit dhe avancimin e rrugës së tij evropiane, e jo në krijimin e tensioneve të panevojshme politike dhe konfuzionit institucional”, kanë shtuar nga MPJ-ja e Malit të Zi. Sa i përket vendimeve të marra nga disa komuna, MPJ-ja e Malit të Zi ka theksuar se ato mund të



krijojnë perceptim të gabuar për mënyrën se si funksionon shteti dhe të kenë ndikim negativ në besueshmërinë e Malit të Zi në arenën ndërkombëtare. “Për rrjedhojë, vendimet e miratuara nga kuvende të veçanta komunale nuk mund të ndikojnë në pozitën ndërkombëtare të Malit të Zi, të ndryshojnë detyrimet e tij ndërkombëtare apo të ndryshojnë politikën e jashtme të vendosur të shtetit. Vendime të tilla përbëjnë akte

politike pa efekt juridik dhe mund të kontribuojnë vetëm në krijimin e një perceptimi të gabuar për funksionimin e institucioneve shtetërore dhe besueshmërinë e Malit të Zi në arenën ndërkombëtare”, është theksuar në përgjigje. Nga Ministria e Punëve të Jashtme të Malit të Zi kanë deklaruar se përgjatë viteve dy vendet kanë pasur marrëdhënie të mira dypalëshe dhe se Podgorica zyrtare do ta

mbështesë Kosovën në pjesëmarrjen dhe anëtarësimin në organizata dhe iniciativa ndërkombëtare e rajonale. “Gjatë viteve, falë një dialogu intensiv politik, Mali i Zi dhe Kosova kanë zhvilluar marrëdhënie shumë të mira dypalëshe, të bazuara në besim të ndërsjellë, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe një perspektivë të përbashkët evropiane dhe euroatlantike. Dy vendet tona vazhdojnë të forcojnë bashkëpunimin në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, në dobi të qytetarëve të tyre. Në këtë kontekst, Mali i Zi do të vazhdojë ta mbështesë pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata dhe iniciativa ndërkombëtare e rajonale”, kanë deklaruar në një përgjigje me shkrim nga MPJ-ja e Malit të Zi. Nisma kundër pavarësisë së Kosovës është nisur në maj të vitit 2026 nga Komuna e Zetës dhe më pas është pasuar nga Komuna e Plevljës.

STRADNER: SERBIA NXIT TENSIONE ME KOSOVËN, OSBE-ja TË MOS MBLIDHET NË SERBI

PRISHTINË, 4 GUSHT - Analistja Ivana Stradner ka kritikuar vendimin e Asamblesë Parlamentare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për ta mbajtur sesionin vjetor të vitit 2027 në Beograd, duke vlerësuar se ky hap i jep legjitimitet presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, pavarësisht prapaktimit demokratik në Serbi. Në një opinion të publikuar nga Stradner, është thënë se Vuçiqi po përballet me sfidën më të madhe politike gjatë më shumë se një dekade në pushtet, për shkak të protestave mbarëkombëtare kundër

korupsionit dhe dobësimit të demokracisë. Sipas saj, në vend që të ushtrojnë presion për reforma, vendet perëndimore i kanë dhënë Vuçiqit një “vulë legjitimiteti” duke mbështetur kandidaturën e Beogradit. Stradner ka argumentuar gjithashtu se Vuçiq ka nxitur paqëndrueshmëri në Ballkanin Perëndimor duke përshkallëzuar vazhdimisht tensionet me Kosovën dhe duke mbështetur liderin pro-rus të serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, i cili, me kërcënimet e tij të përsëritura për shpërbërjen e Republikës Serpska nga Bosnja dhe Hercegovina, ka thelluar paqëndrueshmërinë

politike në rajon. Sipas saj, Serbia ka tentuar gjithashtu të pengojë integrimin e Malit të Zi në institucionet evropiane. Stradner ka rikujtuar se protestat u nxitën pas shembjes së një strehe në stacionin hekurudhor të Novi Sadit, ku humbën jetën 16 persona, ndërsa qytetarët akuzuan qeverinë për korupsion dhe kërkuar përgjegjësi. Ajo ka theksuar se një koalicion dypartiak në Kongresin amerikan, i udhëhequr nga kongresmeni Joe Wilson, ka kërkuar që sesioni i OSBE-së të mbahet në Charleston të Karolinës së Jugut dhe jo në



Beograd, duke argumentuar se regjimi i Vuçiqit ka një histori të shtypjes së lirive civile, destabilizimit të Ballkanit dhe afrimit me regjime autoritare.

Sipas Stradner, miratimi i organizimit të sesionit në Beograd bie ndesh me vlerat e OSBE-së dhe interesat e Shteteve të Bashkuara.

RAMADANI KËRKON LARGIMIN E PRANISË STATIKE TË KFOR-it NGA URA E IBRIT

PRISHTINË, 4 GUSHT - Deputeti i Aleancës, Burim Ramadani, ka kërkuar largimin e pranisë statike të KFOR-it nga ura kryesore e Mitrovicës, duke vlerësuar se janë përmbushur kushtet që kjo të ndodhë. Përmes një postimi në “Facebook”, Ramadani ka deklaruar se ura duhet të bëhet simbol i normalizimit dhe besimit. Ai ka theksuar se prania statike e KFOR-it ka pasur rol të rëndësishëm në periudhat kur situata e sigurisë e ka kërkuar, por çdo masë e jashtëzakonshme duhet të rishikohet kur ndryshojnë rrethanat. Ramadani ka ngritur pyetjen



nëse prania statike në urën kryesore të Mitrovicës është ende e nevojshme, duke

argumentuar se situata e sigurisë duhet të vlerësohet sipas realitetit aktual, se

institucionet vendore kanë kapacitetet për të garantuar sigurinë dhe se një sistem modern sigurie mbështetet në patrullime, monitorim dhe reagim të shpejtë. Ai ka theksuar se hapësirat publike nuk duhet të mbeten përgjithmonë simbol i një situatë të jashtëzakonshme dhe se qëllimi i çdo misioni paqeruajtës është që një ditë prania e tij të mos jetë më e domosdoshme. “Ka ardhur momenti që prania statike e KFOR-it në urën kryesore të Mitrovicës të largohet. Jo si dobësim i sigurisë, por si hap përpara. Sepse, kushtet janë

përmbushur”, ka shkruar Ramadani. Sipas Ramadani, largimi i pranisë statike të KFOR-it nga ura nuk do të përbënte dobësim të sigurisë, por dëshmi se siguria është forcuar dhe një hap drejt normalizimit. Ai ka shtuar se ura duhet të mbrohet nga besimi qytetar, ligji dhe normaliteti, e jo të ruhet përgjithmonë nga ushtarët. “Siguria nuk mbështetet duke qëndruar gjithmonë në të njëjtën pikë. Siguria ndërtohet kur institucionet forcohen, kur qytetarët fitojnë besim dhe kur masat e jashtëzakonshme zëvendësohen me normalitet”, ka shkruar Ramadani.



A I DUHEN KOSOVËS LOBISTË NË SHBA?

Kosova ka mbetur pa kontrata aktive lobimi në ShBA që nga viti 2024, ndërsa ekspertët dhe ish-zyrtarët kanë qëndrime të ndryshme për rolin e lobistëve privatë në promovimin e interesave të vendit në Uashington. Disa e konsiderojnë të domosdoshëm angazhimin e firmave lobuese për të siguruar qasje te vendimmarrësit amerikanë, ndërsa të tjerë vlerësojnë se diplomacia zyrtare, ambasada dhe diaspora duhet të jenë shtyllat kryesore të përfaqësimit të Kosovës

PRISHTINË, 4 GUSHT - Në Uashington, lobimi është pjesë e politikës. Qeveritë nga e gjithë bota paguajnë firma private për të siguruar qasje te institucionet amerikane, për të organizuar takime dhe për të promovuar interesat e tyre politike, ekonomike apo të sigurisë. Për më shumë se dy dekada, edhe Kosova ka ndjekur të njëjtën politikë. Por kjo ka ndryshuar. Që nga qershori i vitit 2024, Kosova nuk ka asnjë kontratë aktive lobimi të regjistruar sipas ligjit

amerikan për agentët e huaj, të njohur si FARA. A është kjo problematike? Për ish-ministrin e Jashtëm, Petrit Selimi, nuk ka dilemë. Sipas tij, veçanërisht gjatë administratës së presidentit Donald Trump, firmat lobuese luajnë rol kyç, sepse krijojnë qasje te njerëzit që marrin vendime. “Është asgjë më pak se tragjike dhe krejtësisht e pakuptueshme që Kosova e ka dobësuar njëkohësisht praninë e saj diplomatike në Uashington dhe ndërveprimin

me lobistët privatë amerikanë”, ka thënë Selimi. Por ka edhe një këndvështrim krejt tjetër. Robin Brooks, ish-zyrtarë e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-së, beson se diplomacia nuk duhet t’u delegohet lobistëve. Sipas saj, ata mund të krijojnë konflikte interesi, mungesë transparence dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht interesat afatgjatë të shtetit prej nga vijnë. “Unë do të preferoja shumë më tepër të punoja me një koleg, një diplomat për të

cilin e di se përfaqëson ministrin e Jashtëm, presidentin apo kryeministrin e vendit të tij”, ka thënë Brooks. Mes këtyre dy qëndrimeve pozicionohet Blerim Vela, ish-shef i kabinetit të ish-presidentes Vjosa Osmani. Ai ka thënë se lobimi është i dobishëm, por vetëm nëse është pjesë e një strategjie më të gjerë. Sipas tij, shtylla kryesore duhet të mbetet Ambasada e Kosovës në Uashington, pastaj angazhimi i diasporës dhe vetëm më pas firmat private të lobimit. “Qeveria e Kosovës dhe institucionet e Kosovës duhet ta kryejnë punën e tyre. Puna e tyre primare është të sigurohen që ambasadat të kenë sa më shumë diplomatë. Pastaj, t’i përcaktojnë

qëllimet...”, ka deklaruar Vela. “Radio Evropa e Lirë” ka pyetur Presidencën dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për planet e Kosovës lidhur me lobimin në Uashington, por nuk ka marrë përgjigje. Në një kohë kur Kosova ende pret nisjen e dialogut strategjik me ShBA-në dhe Uashingtoni kërkon një partner më funksional në Prishtinë, vendet e tjera të rajonit vazhdojnë ta përdorin lobimin si pjesë të politikës së tyre të jashtme. Bosnja dhe Hercegovina ka 16 kontrata lobimi me ShBA-në, Serbia 6, Shqipëria 4 dhe Maqedonia e Veriut 2. Këto kontrata mbulojnë fusha të ndryshme, nga ekonomia dhe energjia deri te promovimi i interesave politike

Begaj takohet me ambasadorin e Ekuadorit, ia kërkon njohjen e Kosovës

Tiranë, 4 gusht - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, ka pritur të martën në një ceremoni zyrtare ambasadorin e jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë të Republikës së Ekuadorit, Esteban Assar

Moscoso Bohman, rezident në Romë, i cili i ka paraqitur letrat kredenciale. Begaj i ka uruar ambasadorit suksese në përmbushjen e misionit të tij diplomatik dhe ka shprehur vullnetin për forcimin e marrëdhënieve

dypalëshe mes Shqipërisë dhe Ekuadorit, si dhe për zgjerimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët. Gjatë takimit, presidenti i Republikës së Shqipërisë, ka vlerësuar bashkëpunimin në kuadër të organizatave

ndërkombëtare dhe ka kërkuar që Ekuadori të konsiderojë mundësinë e njohjes së Republikës së Kosovës, duke e cilësuar këtë si një kontribut të rëndësishëm për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor.



GRUDA: TAKIMET E KURTIT JANË FARSË, NËSE NUK E MERR PRESIDENTIN, AI PLANIFIKON TA ÇOJË VENDIN NË ZGJEDHJE



PRISHTINË, 4 GUSHT - Deputeti i zgjedhur i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, ka deklaruar se takimet e liderit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, me partitë politike janë një farsë. Sipas Grudës, Kurti

synon ta marrë edhe pozitën e presidentit dhe, nëse një gjë e tillë nuk ndodh, kreu i LV-së do ta çojë përsëri vendin në zgjedhje. “Është totalisht improvizim. Kurti ka për qëllim ta marrë presidentin, që të

vendosë pushtet të plotë. Asnjë parti s’duhet ta lejojë këtë. Nëse s’e arrin këtë, do ta çojë vendin në zgjedhje”, ka deklaruar Gruda. Ai ka thënë se PDK-ja e ka kuptuar këtë “improvizim” dhe për këtë

arsye ka vendosur të mos marrë pjesë në takim. Albin Kurti të martën është takuar me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku në përpjekje për të arritur një marrëveshje për krijimin e institucioneve të

reja të vendit pas zgjedhjeve të qershorit. Kurti i është drejtuar me ftesë edhe Partisë Demokratike të Kosovës dhe Aleancës, por krerët e dy partive e kanë refuzuar takimin.

BE-ja KËRKON PEZULLIMIN E RRËNIMEVE NË UJMAN DERI NË VENDIMIN E GJYKATËS

PRISHTINË, 4 GUSHT - Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje institucioneve të Kosovës që të ndalojnë rrënimet e mëtijshme të objekteve në zonën e Liqenit të Ujmanit, derisa gjykata kompetente të marrë një vendim përfundimtar lidhur me pretendimet pronësore. Anitta Hipper, zëdhënëse për politikë të jashtme dhe çështje të sigurisë e kryediplomates së BE-së, Kaja Kallas, është pyetur lidhur me rrënimin e objekteve në pronësi të ndërmarrjes publike “Ibër-Lepenc” në Zubin Potok dhe nëse Brukseli po shqyrton masa në rast se demolimet vazhdojnë. “Ne shprehim keqardhje për

rrënimin e shtëpive, veçanërisht pasi pretendimet pronësore janë ende nën shqyrtim gjyqësor”, ka thënë Hipper. Ajo ka bërë me dije se BE-ja u bën thirrje institucioneve të Kosovës që të ndalojnë çdo rrënim të mëtijshëm dhe të bashkëpunojnë me banorët e prekur dhe autoritetet lokale për të gjetur zgjidhje ligjore dhe të qëndrueshme. Sipas Hipper, çdo veprim i pakthyeshëm, përfshirë rrënimet, duhet të pezullohet derisa gjykata kompetente të nxjerrë një vendim përfundimtar për pretendimet pronësore që ende mbeten të pazgjidhura.



KUVENDI MIRËPRET BASHKATDHEARËT



PRISHTINË, 4 GUSHT - Kuvendi i Republikës së Kosovës do të organizojë aktivitetin tradicional “Bashkatdhetarët në Kuvend”, nga e hëna, 10 gusht, deri të mërkurën, 12 gusht 2026. Të gjithë bashkatdhetarët që dëshirojnë ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës janë të mirëpritur nga ora 12:00 deri në 16:00. Gjatë vizitës, ata do të kenë

mundësi ta njohin nga afër punën e Kuvendit, të vizitojnë sallën ku merren vendime të rëndësishme për vendin dhe të takohen me deputetë të Legjislaturës së XI-të. Me këtë rast, kryeparlamentarja Albulena Haxhiu, përmes një videoje të publikuar në “Facebook”, ka ftuar bashkatdhetarët që ta vizitojnë Kuvendin dhe të

shohin nga afër institucionin ku miratohen ligjet dhe merren vendime të rëndësishme për vendin. “Do të mund të hyni këtu, në sallën e seancave plenare, të shihni vendet ku ulen deputetët që ju keni zgjedhur dhe të mësoni se si zhvillohet puna e Kuvendit, nga shqyrtimi i një projektligji në komisione, deri te votimi i tij në seancë”, ka thënë Haxhiu.

SUPREMJA SHFUQIZON UDHËZIMIN ADMINISTRATIVPËR GRADIMIN E ZYRTARËVE POLICORË



PRISHTINË, 4 GUSHT - Gjykata Supreme ka aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditëses V.Z. ndaj Policisë së Kosovës, duke shpallur të paligjshëm dhe shfuqizuar në tërësi Udhëzimin Administrativ për procedurën e gradimit të zyrtarëve policorë.

Paditësja kishte paditur Policinë e Kosovës, duke kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ, përkatësisht të nenit 7, paragrafëve 2, 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 01/2026 për Procedurën e Gradimit të Zyrtarëve Policorë, të datës 26 maj 2026. Sipas këtij udhëzimi administrativ, ishte paraparë një procedurë e veçantë gradimi, sipas së cilës zyrtarët policorë me së paku 10 vjet përvojë pune aktive në Policinë e Kosovës mund të aplikonin për fitimin e dy gradave njëherësh, pa u zbatuar kufizimet lidhur me kohëzgjatjen minimale të qëndrimit në gradën paraprake. Si rezultat i këtyre dispozitave, zyrtarët policorë që nuk kishin

ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e gradës së rreshterit lejoheshin të konkurronin drejtpërdrejt për gradën e togerit, në të njëjtën procedurë me rreshterët që kishin kaluar proceset paraprake të gradimit dhe kishin ushtruar përgjegjësi mbikëqyrëse.

Gjithashtu, pala e interesit V.S., krahas padisë së paditëses, kishte kërkuar shfuqizimin e tërësishëm të këtij udhëzimi, duke e kontestuar procedurën e hartimit të aktit normativ.

Ndërkaq, pala e paditur, Policia e Kosovës, përmes përgjigjes në padi, kishte kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditëses, duke vlerësuar se ato nuk mbështeteshin në interpretimin sistematik të Ligjit për Policinë, në parimet e drejtësisë administrative dhe as në dokumentacionin administrativ mbi të cilin ishte bazuar nxjerrja e Udhëzimit Administrativ.

Po ashtu, Policia e Kosovës kishte deklaruar se udhëzimi ishte nxjerrë në bazë të kompetencave të deleguara me

Ligjin për Policinë dhe në kuadër të përgjegjësisë të Drejtorit të Përgjithshëm për administrimin dhe menaxhimin e Policisë së Kosovës, me qëllim të rregullimit të procedurës së gradimit të zyrtarëve policorë, zhvillimit të karrierës dhe administrimit efikas të burimeve njerëzore.

Gjykata Supreme, më 28 korrik 2026, ka nxjerrë aktgjykim me të cilin ka aprovuar si të themeltë kërkesëpadinë e paditëses V.Z. dhe të palës së interesit V.S., të paraqitur kundër Policisë së Kosovës, duke shpallur të paligjshëm dhe shfuqizuar në tërësi Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2026 për Procedurën e Gradimit të Zyrtarëve Policorë.

Në vendimin e saj, Supremja ka konstatuar se udhëzimi administrativ i kontestuar bie ndesh me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative. Sipas gjykatës, nuk ka ekzistuar një problem i përcaktuar apo veprim i justifikuar për nxjerrjen e një

udhëzimi të ri, pasi procedura e gradimit kishte qenë e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2019.

Sipas Supremes, në rast të nevojës për plotësimin apo ndryshimin e këtij udhëzimi, do të duhej të ndërmerreshin ndryshimet përkatëse dhe jo të nxirrej një udhëzim i ri, siç ishte vepruar në rastin konkret.

Supremja ka vlerësuar se udhëzimi i kontestuar kishte probleme të shumta në aspektin e justifikimit të nevojave dhe problemit të identifikuar. Po ashtu, gjykata ka evidentuar paqartësi në normat e tij, në kuptueshmërinë dhe qasjen ndaj tyre, si dhe në mundësinë e palëve të interesit për të shprehur mendimin e tyre. Sipas vendimit, kishte edhe referime jo të qarta ndërmjet dispozitave. Më tej, në vendimin e saj, Supremja ka theksuar se në nenin 55, paragrafi 1, pika 1.8 të Ligjit për Policinë përcaktohet se drejtori i përgjithshëm nxjerr akte nënligjore për procedurën e gradimit të personelit policor.

Megjithatë, sipas gjykatës, me udhëzimin e kontestuar drejtori i përgjithshëm kishte ndërhyrë në sistemin e gradimit, duke shpërfillur gradimin e rregullt dhe duke shtuar një kategori të re gradimi për dy grada njëherësh.

Lidhur me këtë, Supremja ka theksuar se aspekti material dhe substancial i sistemit të gradimit mund të rregullohet vetëm përmes ndryshimeve ligjore, pas një analize të gjerë. Gjykata ka vlerësuar se sistemi i deritanishëm është në përputhje me praktikën e rajonit dhe të shteteve të Bashkimit Evropian.

Sipas Supremes, ndryshimet e bëra përmes udhëzimit administrativ përbëjnë tejkalim të autorizimit dhe ushtrim të diskrecionit jashtëligjor nga drejtori i përgjithshëm i Policisë, një kompetencë të cilën ligji nuk ia njeh.

Në vendimin e saj, Gjykata Supreme ka konstatuar gjithashtu se Udhëzimi Administrativ i kontestuar e zhvlerëson vlerësimin e performancës si një kriter të rëndësishëm për secilën pozitë, veçanërisht në Policinë e Kosovës. Sipas vendimit, pesha e performancës është ulur nga 10 për qind, sa ishte përcaktuar me udhëzimin e vitit 2019, në 5 për qind me udhëzimin e ri.

Ndër të tjera, Supremja ka konstatuar disrepancë dhe probleme lidhur me kriterin e përvojës apo qëndrimit në gradë në raport me performancën, të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të udhëzimit të kontestuar.

Gjykata ka vlerësuar se qëndrimi dyvjeçar në një gradë dhe vlerësimi i performancës për tri vitet e fundit nuk janë në linjë me njëra-tjetrën dhe se nuk është e qartë se çfarë është synuar të arrihet me një rregullim të tillë. Po ashtu, në vendim është theksuar se një procedurë e tillë gradimi është në kundërshtim me parimin e meritokracisë dhe barazisë, ndërsa paraqet edhe disbalancë në sistemin e gradave dhe demotivim për personat e sistemuar si ushtrues detyre apo në grada në pritje, të cilët do të hynin në konkurrencë me kolegët e tyre me grada më të ulëta.

Policia në Ferizaj shqipton 281 gjoba ndaj shoferëve për përdorimin e telefonit gjatë ngasjes

FERIZAJ, 4 GUSHT - Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë muajit korrik 2026 ka shqiptuar 281 gjoba ndaj shoferëve në rajonin e Ferizajt për përdorimin e telefonit gjatë ngasjes së automjetit.

Policia ka apeluar te të gjithë pjesëmarrësit në trafik që të përqendrohen plotësisht në drejtimin e automjetit dhe të shmangin çdo lloj shpërqendrimi, pasi edhe një sekondë pakujdesie gjatë

përdorimit të telefonit mund të ketë pasoja serioze për jetën e njerëzve.

Sipas njoftimit të policisë rajonale të Ferizajt, përdorimi i telefonit gjatë ngasjes vazhdon të jetë një nga shkaqet kryesore të aksidenteve rrugore. Gjatë muajit korrik, janë shqiptuar gjithsej 281 gjoba ndaj shoferëve që kanë shkelur këtë rregull dhe kanë rrezikuar sigurinë e tyre dhe të pjesëmarrësve të tjerë në

komunikacion.

Policia rajonale e Ferizajt u ka bërë thirrje qytetarëve që të raportojnë çdo shkelje të rregullave të trafikut, qoftë drejtpërdrejt në stacionin më të afërt policor, përmes aplikacionit digjital "Lajmëro Policinë" ose në numrat kujdestarë 192, 0290/326-250 dhe 0290/322-406. Policia ka siguruar qytetarët se konfidencialiteti i të dhënave të tyre do të ruhet plotësisht.



PROKURORIA SPECIALE PËR GËRMIMET NË ZUBIN POTOK: HETIMET PO VAZHDOJNË NË NJË LOKACION TË TRETË



PRISHTINË, 4 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se në koordinim me Policinë e Kosovës, hetimet lidhur me rastin e dyshuar të krimeve të luftës në komunën e Zubin Potokut po vazhdojnë intensivisht.

Sipas prokurorisë, aktualisht hetimet po zhvillohen në një lokacion të tretë, ndërsa prokurorja përgjegjëse ka qenë në vendngjarje së bashku me hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Luftës dhe ekspertët forenzikë, për të

mbikëqyrur veprimet hetimore. Deri më tani, tre persona janë arrestuar nën dyshimin për kryerjen e veprës penale “Krime lufte kundër popullsisë civile”. Gjatë hetimeve janë kontrolluar disa lokacione. Në fshatin Jabukë janë gjetur mbetje, të

cilat do t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjeko-ligjore dhe analizave të ADN-së për identifikim. Ndërkohë, gërmimet në fshatin Kalludër e Vogël janë duke vazhduar. Për shkak të fazës së ndjeshme të hetimit, Prokuroria Speciale

ka bërë me dije se për momentin nuk mund të japë informacione të tjera. “Informacione shtesë do të publikohen kur kjo të jetë e mundur pa cenuar hetimin”, është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

KPK-ja HAP KONKURS PËR 34 PROKURORË TË RINJ, 10 VENDE TË REZERVUARA PËR KOMUNITETIN SERB



PRISHTINË, 4 GUSHT - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka marrë vendim për shpalljen e konkursit për rekrutimin e 34 prokurorëve të rinj në sistemin prokurorial të vendit. Sipas vendimit të KPK-së, nga numri i përgjithshëm i pozitave të lira, 10 vende janë rezervuar për kandidatët nga komuniteti serb, në përputhje me obligimet ligjore për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në institucionet e Kosovës. Fillimisht është prezantuar analiza që përcakton nevojën e

sistemit prokurorial për prokurorë të rinj. Anëtarë Dardan Vuniqi, gjatë prezantimit të kësaj analize, ka deklaruar se janë 177 prokurorë aktivë dhe 34 pozita të lira, prej të cilave 10 janë të rezervuara për komunitetin serb. “Neve obligohemi të ndërmarrim veprime për rritjen e përfaqësimit të komunitetit serb në sistem. Komisioni rekomandon 10 vende për komunitetin serb, 24 pozita të lira për pjesën tjetër”, ka deklaruar Vuniqi. Ndërsa kryesuesi Arian Gashi ka

theksuar se përfaqësimi i komuniteteve është në interes të Kosovës dhe, krahas kësaj, përbën edhe obligim ligjor si rezultat i dialogut me shtetin fqinj, ku është marrë obligim bazuar në marrëveshje. “Andaj, inkurajoj pjesëtarët e komunitetit serb që të aplikojnë. Do të jetë proces i drejtë, i pavarur dhe i paanshëm”, është shprehur Gashi. Në fund, me shtatë vota për, është miratuar propozimi për shpalljen e konkursit për rekrutimin e prokurorëve të rinj.

Kosova nënshkruan marrëveshje me Institutin e Bazelit për rikthimin e pasurive të paligjshme

PRISHTINË, 4 GUSHT - Kryeprokurori i Shtetit, Zejnulla Gashi, drejtoresha ekzekutive e Institutit të Bazelit për Qeverisje në Zvicër (IBQ), Elizabeth Andersen dhe drejtori i Qendrës Ndërkombëtare për Rikthimin e Pasurive (QNRP – ICAR), Iker Lekuona, kanë nënshkruar në formë elektronike një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon të

avancojë përpjekjet për rikthimin dhe riatdhesimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme përmes korrupsionit ose formave të tjera të abuzimit me pushtetin. Marrëveshja ka për qëllim rikthimin e pasurive të paligjshme që ndodhen jashtë vendit dhe që ligjërisht i përkasin Republikës së Kosovës. Për më tepër, kjo marrëveshje

bashkëpunimi synon të lehtësojë bashkëpunimin më efektiv me autoritetet e shteteve të tjera në lidhje me gjurmimin, identifikimin dhe ndjekjen penale të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimin të organizuar. Gjithashtu, përmes këtij

bashkëpunimi, Instituti i Bazelit për Qeverisje, nëpërmjet këshillave strategjike, udhëzimeve praktike dhe asistencës, do ta mbështesë Prokurorin e Shtetit në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të larta të bashkëpunimit ndërkombëtar.



AUV-i: NË 46 RASTE U GJET PRANI OSE MOSDEKLARIM I VAJIT TË PALMËS NË PRODUKTET E QUMËSHTIT



PRISHTINË, 4 GUSHT - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kanë bërë me dije se gjatë një aksioni të zgjeruar të kontrolleve në sektorin e qumështit janë identifikuar dhjetëra mospërputhje, ku më e shpeshta lidhet me praninë ose mosdeklarimin e vajit të palmës në produkte. Ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, ka deklaruar se qëllimi i kontrolleve nuk ishte gjetja e fajtorëve, por evidencimi i së vërtetës dhe mbrojtja e konsumatorëve. Ai ka theksuar se disa përpunues kanë tradhtuar besimin e fermerëve dhe qytetarëve.

Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Bekim Hoxha, është shprehur se aksioni është zhvilluar në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë gjatë periudhës prill-korrik 2026. “Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në koordinim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjatë periudhës prill-korrik 2026 ka realizuar një aksion të zgjeruar të kontrollit në sektorin e qumështit dhe produkteve të qumështit, me qëllim verifikimin e sigurisë ushqimore, autenticitetit të produkteve,

përputhshmërisë së etiketimit me legjislacionin në fuqi dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Për të arritur këtë qëllim, Agjencia ka mobilizuar të gjitha kapacitetet inspektuese dhe laboratorike në nivel vendi”, ka deklaruar ai.

Hoxha ka bërë me dije se gjatë këtij aksioni janë analizuar qindra mostra. “Si rezultat i këtij aksioni janë marrë gjithsej 495 mostra, të cilat janë analizuar për parametra të ndryshëm të autenticitetit dhe sigurisë ushqimore, duke përfshirë përmbajtjen e yndyrës, proteinës, praninë e vajit të palmës, yndyrave bimore, niseshtesë apo amidonit dhe qumështit pluhur. Rezultatet e këtij monitorimi kanë ofruar një pasqyrë të plotë, të qartë dhe të bazuar në evidenca mbi gjendjen reale të sektorit. Ky aksion përfaqëson një nga proceset më të gjera dhe më gjithëpërfshirëse të kontrollit zyrtar të ndërmarrë deri më tani në sektorin e qumështit”, ka theksuar ai.

Hoxha ka sqaruar se aksioni nuk ishte ndërmarrë kundër prodhuesve, por për të garantuar transparencë dhe mbrojtje të konsumatorit. “Këto kontrolle kanë identifikuar një numër të madh mospërputhjes. Nga analizat laboratorike

janë evidentuar disa mospërputhje në nivel përbërësish. Nga gjithsej 93 mospërputhje të identikuara, 46 raste kanë të bëjnë me praninë ose deklarimin e vajit të palmës. Kjo përfaqëson pothuajse gjysmën e të gjitha mospërputhjeve të identikuara gjatë aksionit dhe e bën vajin e palmës çështjen më të shpeshtë të identifikuar gjatë kontrolleve tona. Analizat tona, të cilat janë realizuar në laboratorin e AUV-it, tregojnë se në mbi 91 për qind të rasteve të mospërputhjeve, përbërësit nuk janë deklaruar në etiketë në mënyrën e kërkuar bazuar në legjislacionin në fuqi. Kjo nënkupton se konsumatori nuk ka pasur informacion të plotë dhe të saktë mbi përbërjen e produktit që ka blerë. Kur një produkt përmban vaj palme, yndyrë bimore apo përbërës të tjerë alternativë, kjo duhet të deklarohet qartë. Konsumatori duhet të informohet saktë dhe në mënyrë transparente”, ka deklaruar ai.

Ndërsa ministri në detyrë i Bujqësisë, Armend Muja, ka theksuar se institucionet do të veprojnë në përputhje me ligjin dhe se raporti i AUV-it do t'i nënshtrohet procedurave administrative. “Nuk kishim për qëllim që të gjendej fajtori.

Qëllimi ishte që të gjendej e vërteta. Aty duhet të mbështeten provat, analizat laboratorike, dokumentacioni teknik dhe procedurat e rregullta administrative. Për këtë arsye, kontrollet u zhvilluan në mënyrë të koordinuar dhe të dokumentuar dhe përfshinë kontrolle të plota gjithandej. Dua të theksoj edhe një parim thelbësor. Në një shtet demokratik, raportet e kontrollit zyrtar nuk janë qëllim në vetvete. Ato janë instrument për të mbrojtur interesin publik. Institucionet nuk mund të mjaftohen vetëm me evidencimin e shkeljeve, ato kanë detyrim të reagojnë në mënyrë proporcionale, të ligjshme dhe efektive”, është shprehur ai.

Muja ka bërë me dije se nga sot do të nisnin procedurat për zbatimin e ligjit, duke theksuar se qumështi i fermerëve kosovarë është i sigurt, ndërsa problemet janë evidentuar te përpunuesit dhe distributorët. “Për këtë arsye, raporti dhe konstatimet e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë fillimisht do të ndjekin procedurën, siç e përcakton ligji për procedurën administrative. Nga sot, kur po flasim, do të nxirret vendim sa i përket procedurës së zbatimit të ligjit në lidhje me rastet dhe raportin në fjalë. Ajo çfarë ne

kërkojmë dhe është e rëndësishme që të kuptohet është se, fillimisht, prodhimi i qumështit dhe aktivitetet e qumështit, si dhe qumështi i fermerëve tanë, janë produkte që testohen nga AUV-i. Qumështi i fermerëve tanë është cilësi që ne e garantojmë përmes kontrolleve zyrtare. Qumështi i fermerëve tanë është qumësht i mirë. Por jo gjithmonë, pas dorëzimit, ruhet ajo cilësi. Dhe kjo ka qenë arsyeja e kontrolleve zyrtare pikërisht te përpunuesit dhe distributorët.

Sipas raporteve, ka të tillë që e kanë tradhtuar besimin e fermerëve dhe e kanë tradhtuar besimin e konsumatorëve. Për këtë, unë i kam kërkuar AUV-it që të veprojë proporcionalisht, por duhet pasur parasysh interesi jetik i Republikës së Kosovës për të mbrojtur konsumatorët, shëndetin publik dhe fermerët, si dhe ato aktivitete të aprovuara. Sepse sot ka nevojë që të prodhohet qumësht, sot ka nevojë që të prodhohen produkte të qumështit dhe sigurisht se secili partner dhe përpunues që është i gatshëm të punojë me AUV-in dhe Ministrinë e Bujqësisë do të mbështetet. Ne do të mbështesim vetëm ato aktivitete që janë të aprovuara”, ka deklaruar Muja.

GAP-I PUBLIKON INDEKsin E TRANSPARENCËS BUXHETORE, 10 KOMUNA MARRIN PIKËT MAKSIMALE

PRISHTINË, 4 GUSHT - Instituti GAP ka publikuar raportin "Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave 2025", i cili vlerëson transparencën buxhetore në 38 komunat e Kosovës. Sipas raportit, mesatarja e transparencës buxhetore në vitin 2025 ka arritur në 64.5 pikë, nga 61 pikë sa ishte një vit më parë.

Në total, 10 komuna kanë marrë 100 pikë, ndërsa 19 nga 38 komunat kanë arritur të paktën 89.5 pikë. Në anën tjetër, Klokoti, Leposaviqi, Parteshi, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë grumbulluar asnjë pikë.

Gjatë vitit 2025, komunat kanë publikuar gjithsej 240 dokumente buxhetore, prej të cilave 133 kanë qenë dokumente të raportimit financiar të buxhetit.

Në kuadër të planifikimit të buxhetit për vitin 2026, komu-



nat kanë organizuar gjithsej 119 dëgjime buxhetore me qytetarët. Nga 38 komunat, 28 kanë organizuar së paku katër dëgjime, ndërsa komunat e tjera kanë zhvilluar nga një deri në tri dëgjime. Sa i përket mënyrës së publikimit, 76 për qind e dokumenteve janë publikuar në formate të hapura dhe lehtësisht të përdorshme, kryesisht Excel dhe Word. Ndërkohë, 8 për qind janë publikuar në PDF dhe 16 për qind si

dokumente të skanuara. Dokumentet më të publikuara kanë qenë Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve, të cilat janë publikuar nga 30 komuna. Po ashtu, 29 komuna kanë publikuar raportet financiare për tremujorin e parë dhe të dytë, ndërsa 28 kanë publikuar Raportin Vjetor Financiar për vitin 2025.

Në krahasim me vitin paraprak, Obiliqi ka shënuar rritjen më të

madhe, me 60 pikë më shumë, pasuar nga Ferizaj me 52.5 pikë dhe Gjlani me 43.5 pikë.

PDK-ja: Komunitat e udhëhequra nga ne në vitin 2025, lidere të transparencës buxhetore

Komunitat e udhëhequra nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë shënuar performancën më të lartë në Indeksin e Transparencës Buxhetore të Komunave për vitin 2025, të publikuar nga Instituti GAP. Sipas raportit, Ferizaj, Kaçaniku, Mitrovica e Jugut, Prizreni dhe Vushtrria kanë marrë rezultatin maksimal prej 100 pikësh, duke u renditur në vendin e parë në nivel vendi. Drenasi është vlerësuar me 95 pikë, Hani i Elezit me 97 pikë, ndërsa Skenderaj me 92.5 pikë. "Është e rëndësishme të thek-

sohet se raporti vlerëson transparencën buxhetore gjatë vitit 2025. Në periudhën e vlerësuar, Mitrovica e Jugut udhëhoq nga Partia Demokratike e Kosovës. Prandaj, rezultati maksimal prej 100 pikësh i kësaj komune është pjesë e performancës së qeverisjes komunale të PDK-së për vitin që mbulon raportin. Tetë komunat e udhëhequra nga PDK-ja asokohe kanë arritur një mesatare prej rreth 98.1 pikësh, dukshëm më të lartë se mesatarja e përgjithshme e komunave të Kosovës, e cila ishte 64.5 pikë", është thënë në komunikatën e PDK-së.

PDK-ja ka vlerësuar se këto rezultate dëshmojnë përkushtimin e kryetarëve dhe administratave komunale të PDK-së për qeverisje të hapur, menaxhim transparent të financave publike dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve.

KOSOVA NUK ËSHTË PJESË E EUROZONËS, POR QYTETARËT E SAJ MUND TË VOTOJNË PËR DIZAJNIN E RI TË KARTËMONEDHAVE EURO



PRISHTINË, 4 GUSHT - Qytetarët e Kosovës kanë mundësinë të japin mendimin e tyre për pamjen e ardhshme të kartëmonedhave euro, në kuadër të konsultimit publik të organizuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Sipas mediumit kroat "tportal.hr", BQE-ja ka përzgjedhur 10 propozimet finale për dizajnin e ri të kartëmonedhave euro, pas një konkursi ku janë dorëzuar më shumë se 1,200 punime. Propozimet bazohen në dy tema kryesore: "Kultura Evropiane" dhe "Lumenjtë dhe shpendët".

Ky medium ka raportuar se, ndonëse mund të pritej që në këtë proces të merrnin pjesë

vetëm qytetarët e vendeve të eurozonës, konsultimi publik është i hapur edhe për qytetarët e Kosovës, Malit të Zi, Andorrës, Monakos, Vatikanit dhe San Marinos. Mediumi kroat i është referuar një përgjigjeje të Bankës Kombëtare të Kroacisë, sipas së cilës anketa "online" është e hapur për të gjithë personat në Evropë, çka nënkupton se mund të marrin pjesë edhe qytetarët e vendeve që nuk janë pjesë e eurozonës. Ndërkohë, edhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK) u ka bërë thirrje qytetarëve të përfshihen në këtë konsultim publik. Në një njoftim zyrtar, BQK-ja ka bërë me dije se BQE-ja ka

prezantuar propozimet e përzgjedhura për dizajnin e serisë së re të kartëmonedhave euro dhe ka hapur konsultimin publik, duke ftuar qytetarët të shprehin preferencat e tyre për dizajnin e ardhshëm. BQK-ja ka theksuar se, meqenëse euro është valuta zyrtare e Republikës së Kosovës, kjo nismë ka rëndësi të veçantë edhe për qytetarët e vendit. "Edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e Bashkimit Evropian dhe e eurozonës, aspirata jonë për integrim evropian po mbështetet përmes reformave të rëndësishme, përfshirë modernizimin e sistemit të

pagesave dhe avancimin e procesit të integritimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA)", është thënë në njoftimin e BQK-së. Sipas BQK-së, në kuadër të angazhimit për edukimin dhe informimin financiar, qytetarët mund të njihen me propozimet e reja të dizajnit të kartëmonedhave euro, të marrin pjesë në konsultimin publik të organizuar nga BQE-ja dhe të përcjellin procesin e përzgjedhjes së dizajnit fitues, i cili pritet të shpallet në fund të këtij viti. Megjithatë, sipas "tportal.hr", votimi i qytetarëve nuk do të jetë vendimtar për pamjen përfundimtare të

kartëmonedhave. Krahas konsultimit publik, Banka Qendrore Evropiane po zhvillon edhe një hulumtim me një mostër përfaqësuese të qytetarëve të vendeve të eurozonës. Rezultatet e të dy proceseve, së bashku me vlerësimet profesionale dhe teknike, do t'i paraqiten Këshillit Drejtues të BQE-së, i cili do të marrë vendimin përfundimtar për dizajnin e ri të kartëmonedhave euro. Konsultimi publik është i hapur deri më 21 shtator, ndërsa dizajni fitues pritet të shpallet nga BQE-ja në fund të vitit. Kartëmonedhat e reja do të hyjnë në qarkullim vetëm disa vite pas miratimit të dizajnit përfundimtar.

PSE DHE KUSH E VRAU HASAN RIZA PASHËN?



Nga: Hasan BELLO

Në interes të lexuesve të ndryshëm që më shkruajnë dhe më pyesin, duke marrë shkas nga një emision televiziv lidhur figurën e Esat pashë Toptanit, rolin e tij në mbrojtjen e Shkodrës nga agresioni serbo-malazez në vitet 1912-1913 dhe mbi të gjitha për vrasjen e Hasan Riza Pashës, po sqaroj publikisht.

Për Luftën e Shkodrës ka shumë libra dhe pak studime. Për këtë arsye, ka vite që mbledh materiale arkivore dhe literaturë. Por, për shkak të mbështetjes financiare më duhet ende disa kohë për të realizuar një studim që kam nisur, duke u mbështetur në burime dokumentare.

Megjithatë, më afër të vërtetës për këtë ngjarje kanë shkruar këta autorë shqiptarë: 1) Tahir Kolgjini i cili që në 1977 ka botuar një libër në Stamboll, Esat Pashë Toptani tradhëtar apo patriot?, i ribotuar dy herë; 2) Ilir Ikonomi dhe 3) dy librat e intelektualit tironc Xhemal Kusi. Ky i fundit jep edhe emrat e oficerëve shqiptarë që organizuan vrasjen e Hasan Riza Pashës, si vendim unanim, për arsye se ai kishte planifikuar tërheqjen.

Kjo e fundit është pranuar edhe nga dy ndihmësit e Hasan Riza Pashës, që ishin njëkohësisht anëtarë të shtabit që drejtoi luftën. Në vitin 1933 ata botuan librin Mbrojtja e Shkodrës, të cilin unë e kam fotokopjuar qëkur isha student në këtë qytet në bibliotekën e universitetit.

Për kujtim e ruaj ende dhe sot. Më pas libri në fjalë u ribotua më 2007 nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Turke në Ankara (Abdurrahman Nafiz i Kiramettin, 1912-1913, Balkan Savaşı’nda İşkodra Savunması (I-II Cilt), Ankara, Genelkurmay Başkanlığı, 2007). Pra, konsiderohet burim serioz nga dëshmitarë të dorës së parë.

Në këtë libër autorët shpjegojnë se Hasan Riza Pasha kishte marrë këtë vendim për fatin e kalasë: “Dhjetë ditë para se të mbaronin rezervat e ushqimit, do t’u jepnim ushtarëve tri ditë leje

dhe do t’i ushqenim mirë. Ditën e katërt do të dilnim nga zona midis Taraboshit dhe Bunës drejt Tivarit (Barit), do të marshonim drejt portit austriak të Spicës (Spizza), që ndodhej 60 kilometra larg Shkodrës. Duke e pasur Austrinë në krahët tanë, do të qëndronim në një vijë mbrojtjeje që do ta forconim brenda Malit të Zi, do të rezistonim derisa të mbaronin plotësisht furnizimet dhe, nëse do të detyroheshim, do të kalonim në territorin austriak”. Hollësitë e këtij plani i kishte diskutuar me major Abdurrahman Nafiz Beun.


Në Shkodër dhe në frontet e tjera do të lireshin disa batalione rezerviste dhe vullnetarë vendas. Njërive do t’u thuhej: “Flota osmane do të zbarkojë trupa në Tivar dhe Ulqin; ne do të shkojmë t’i presim dhe do t’u hapim rrugën. Kështu do të krijohej një entuziazëm i madh dhe me këtë vrull do të sulmoheshin forcat malazeze në frontin e Taraboshit. Mendohej se përballë Taraboshit, në male, ndodhej vazhdimisht një brigadë armike dhe, për shkak të përforcimit të vazhdueshëm të armikut në atë front, hezitohet të

ndërmerrej ky operacion. Hasan Riza Pasha, në përgjithësi, e mbante shumë të fshehtë planin e veprimit që kishte menduar”. Në fakt flota osmane nuk do të zbarkonte me të vërtetë në Tivar dhe në Ulqin. Ky ishte një truk për të motivuar forcat.


Dhe, çfarë ndodhi? Plani u mësua nga Esat Pasha dhe oficerët shqiptarë, të cilët më kot u përpoqën ta bindnin Hasan Riza Pashën se terreni i Malit të Zi ishte shumë i thepisur dhe nuk do të lejonte tërheqjen e trupave osmane.

Nga ana tjetër, largimi nga Shkodra do ta linte popullsinë në mëshirë të fatit dhe bajonetave serbo-malazeze. Nuk duhet harruar se më shumë se gjysma ose aty-aty me forcat osmane, ishin forcat vullnetare/rezerviste që kishte mbledhur Esat Pasha. Çdo të bëhej me këto forca pas largimit të trupave osmane? Prandaj, junta shqiptare (emrat i jep Xhemal Kusi) mori vendim të vriste Hasan Riza Pashën dhe të vijonte mbrojtjen e Shkodrës e cila u realizua me dinjitet edhe për gati tre muaj e gjysmë derisa Fuqitë e Mëdha morën vendim që ajo t’i ngelte shtetit të ardhshëm shqiptar.

Betejat më të përgjakshme kundër serbo-malazezve u zhvilluan mbas vrasjes së Hasan Riza Pashës. Shumë shqiptarë me siguri që nuk kanë dëgjuar për Betejën ose “Kasaphanën e Bërdicës”, ku për disa orë janë vrarë nga të dyja palët më shumë ushtarë sesa janë vrarë në vitet e Luftës së Dytë Botërore nga të gjitha formacionet politike.



Faqja e librit në turqisht që flet për planin e tërheqjes së Hasan Riza Pashës



Armend Dallku rikthehet në krye të Dukagjinit

KLINË, 4 GUSHT - Klubi futbollistik Dukagjini ka zyrtarizuar rikthimin e Armend Dallkut në postin e kryetrajnerit. Klubi nga Klina ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me teknikun kosovar, i cili nis një tjetër

aventurë në stolin e skuadrës. Përmes një komunikate zyrtare, Dukagjini e ka cilësuar Dallkun si një figurë të njohur për klubin dhe futbollin kosovar, duke theksuar se rikthimi i tij është një hap i rëndësishëm për

vazhdimësinë e projektit dhe realizimin e objektivave sportive. Drejtuesit e klubit besojnë se përvoja, profesionalizmi dhe përkushtimi i Armend Dallkut do ta ndihmojnë Dukagjinin të

ketë rezultate pozitive në sezonin e ri. Me këtë emërim, Dallku rikthehet sërish në Klinë, me synimin për ta udhëhequr skuadrën drejt një sezoni sa më të suksesshëm.



KOSOVA ME 163 SPORTISTË NË LOJËRAT MESDHETARE



Prishtinë, 4 gusht - Kosova do të përfaqësohet në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026" me numrin më të madh të sportistëve dhe sporteve në historinë e pjesëmarrjes së saj në këtë ngjarje multisportive, ka njoftuar Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Delegacioni i Kosovës do të

përbëhet nga 163 sportistë, prej tyre 87 meshkuj dhe 76 femra, të cilët do të garojnë në 21 sporte, me synimin për ta përfaqësuar vendin sa më denjësisht.

Për herë të parë, Kosova do të garojë me katër sporte ekipore: futboll (meshkujt U21 dhe femrat U19),

volejboll (meshkujt dhe femrat), hendboll (meshkujt dhe femrat) dhe basketboll 3x3 (meshkujt dhe femrat). Në dy edicionet e kaluara të Lojërave Mesdhetare, Kosova ka fituar gjithsej 10 medalje, nëntë në xhudo dhe një në boks.

Lojërat Mesdhetare "Taranto

2026" do të zhvillohen nga 21 gushti deri më 3 shtator 2026. "Një moment i veçantë gjatë ceremonisë së mbylljes do të jetë dorëzimi i flamurit të Lojërave Mesdhetare Kosovës, si vendi mikpritës i edicionit të ardhshëm, Prishtina 2030", ka njoftuar KOK-u.

TRABZONSPORI KËRKON 20 MILIONË EURO PËR MUÇIN

TRABZON, 4 GUSHT - Ernest Muçi është kthyer në një nga emrat më të përfolur në Turqi gjatë vitit të fundit, ndërsa paraqitjet e tij kanë zgjuar interesimin e disa klubeve edhe jashtë futbollit turk. Në fakt, interesimi i fundit për Muçin është thënë se ka detyruar Trabzonsporin të

caktojë çmimin për lirimin e tij. Së fundmi, është raportuar se interesim për shërbimet e tij ka shfaqur skuadra e Premierligës, Aston Villa, por Trabzonspori ka qenë i prerë në kërkesën për ta liruar Muçin. Skuadra turke ka kërkuar jo më pak se 20

milione euro për ta lënë të lirë futbollistin e Kombëtares së Shqipërisë, i cili ka kontratë me Trabzonsporin deri në vitin 2029. Kërkesa e lartë e Trabzonsporit ka bërë që Aston Villa të tërhiqet nga interesimi për Muçin, por kjo nuk do të thotë se klubi

anglez nuk do të bëjë ndonjë tjetër tentativë deri në fund të afatit kalimtar të verës. Muçi sezonin e kaluar ishte i huazuar te Trabzonspori, klub që muaj më parë e bleu kartonin e tij nga Beshiktashi për një shumë totale prej 11 milionë eurosh.



TRUMP: DO TË BËJ GJITHÇKA PËR TA MBAJTUR INFANTINON NË KRYE TË FIFA-S

UASHINGTON, 4 KORRIK - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino po përballet me presion për të dhënë dorëheqjen, pasi propozimi i tij për shitjen e një pjese të aseteve komerciale të FIFA-s, me vlerë rreth 15 miliardë dollarë, nuk arriti të miratohej. Sipas "The Telegraph", presidenti amerikan, Donald Trump është i vendosur të bëjë gjithçka që është e mundur për ta mbajtur Infantinon në krye të qeverisë botërore të futbollit. Raportimet fillestare pretendonin se Infantino do të zhvillonte takime me zyrtarë të administratës amerikane,



përfshirë Sekretarin e Shtetit, Marco Rubio, për të siguruar mbështetje politike, por këto

pretendime janë mohuar nga FIFA dhe Departamenti Amerikan i Shtetit.

Megjithatë, një zyrtar i lartë i administratës amerikane, i cituar nga "The Telegraph", ka deklaruar se Trump e vlerëson Infantinon për rolin e tij në organizimin e Kupës së Botës 2026 në ShBA, të cilën presidenti amerikan e ka cilësuar si "Kupën e Botës më të mirë të të gjitha kohërave". Marrëdhëniet mes Trumpit dhe Infantinos është forcuar ndër vite. Që nga takimi i tyre i parë në vitin 2018, presidenti i FIFA-s ka kultivuar raporte të afërta me liderin amerikan, ndërsa gjatë shortit të Kupës së Botës 2026 i dhuroi atij një trofe të artë me emrin e tij dhe një

medalje përkujtimore. Sipas "The Telegraph Sport", Federata Angleze e Futbollit (FA) po punon për krijimin e një koalicioni ndërkombëtar kundër tij, ndërsa UEFA ka nisur kontakte me federata në Afrikë dhe Azi për të siguruar mbështetje për një mocion mosbesimi. Megjithatë, deri më tani asnjë federatë afrikane apo aziatike nuk ka kërkuar publikisht largimin e Infantinos. Nëse iniciohet një mocion mosbesimi, rregullat e FIFA-s kërkojnë që ai të shpallet të paktën tre muaj para votimit, duke e bërë kohën një faktor kyç në zhvillimet e ardhshme.

Fulhami transferon Gonzalo Garcian nga Real Madridi

FULHAM, 4 GUSHT - Fulhami ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit spanjoll Gonzalo Garcia nga Real Madridi, me 22-vjeçarin që ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare me

klubin londinez, e vlefshme deri në vitin 2031. Fulhami do të paguajë rreth 40-42 milionë euro për 70 për qind të kartonit të tij, ndërsa Real Madridi do të mbajë pjesën e

mbetur të të drejtave të lojtarit. Gonzalo Garcia, i cili është produkt i akademisë së "Los Blancos", shkëlqeu sezonin e fundit me ekipin e parë, duke shënuar tetë gola

dhe duke dhuruar tri asistime në 39 paraqitje. Ai gjithashtu përfundoi si golashënuesi më i mirë në Kupën e Botës për Klube, me katër gola të shënuar.





Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria tregtare “AMICUS” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr UNIK: 810844979 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “AMICUS” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810844979 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “AMICUS” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810844979 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

